



Prishtinë: 12.07.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1012_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1807_05_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **11.06.2018**

në seancën e mbajtur më datë 12.07.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin M.I , nga Besiana me shifër të konsumatorit: DPR - 90034570 si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1807_05_18 i datës 23.05.2018.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 11.06.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se rezultati i shqyrtimit të njehsorit elektrik nr.35024160 kanë theksuar se njehsori nuk është në rregull (një bllobë e këputur) , tarifa e parë dhe e dytë janë në rregull, nga ana e jashtme dëmtime nuk ka, dhe se njehsori elektrik është brenda kufijve të lejuar të matjes. Në ankesën e KESCO gjithashtu është theksuar se DMK në ZRRE vendimin e tij e nuk e bazon në raportin e kalibrimit por vetëm nga rrjedha e energjisë elektrike dhe mesataren e shpenzimit në periudha të ndryshme, e që këto konstatime nuk janë bindëse pasi që konsumatori nuk do të thotë që patjetër duhet ta ketë shpenzimin e njëjtë në të gjitha periudhat. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së nr.ZRRE/DMK_V_1807_05_18 i datës 23.05.2018 për konsumatorin M. I. me shifër DPR - 90034570.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 12.07.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar si të bazuara konstatimet e bëra nga shkalla e parë në të cilat theksohet se në periudhën 10.02.2014 konsumatori i është larguar nga



matja njehsori elektrik nr.34713817 me gjendje TL=16294 kWh dhe TU=11229 kWh, si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr.35024160 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh, dhe se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike në këtë periudhë është përputhur me gjendjen e shpenzimit të rrjedhës së energjisë elektrike. Gjithashtu duhet theksuar se me datë 06.12.2017 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, dhe gjatë inspektimit kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr.35024160 me gjendje TL=024423 kWh dhe TU=010594 kWh, si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr.67788719 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO lidhur me atë se njehsori elektrik gjatë shqyrtimit nga ana e kalibrimit është konstatuar se është në brenda kufijve të matjes, Bordi i ZRRE-së thekson se ka mospërputhje të konstatimeve, punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit ngase me datë 15.03.2018 kanë bërë shqyrtimin e saktësisë së matjes të njehsorit elektrik nr. 35024160 ku kanë konstatuar se: njehsori elektrik nuk është në rregull, njehsori elektrik ka një vulë (bllombë) të këputur, tarifa e parë dhe tarifa e dytë është në rregull, nga ana e jashtme njehsori dëmtime nuk ka si dhe kanë konstatuar se gabimi në matje është **+0.11%**. Po ashtu me datë 20.03.2018 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit për shqyrtimin detaj të njehsorit kanë shqyrtuar njehsorin elektrik nr. 35024160 dhe kanë konstatuar se: Njehsori elektrik ka një vulë (bllombë) të këputur kurse një vulë e ka ne rregull, nga ana e jashtme nuk vërehen dëmtime tjera si dhe ne brendi të njehsorit komisioni nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi. Bazuar në të gjeturat përkatësisht shqyrtimin e saktësisë së matjes nga qendra e kalibrimit për njehsorin elektrik nr.35024160 konstatohet se gabimi në matje është brenda kufijve të lejuar matës, mirëpo është theksuar se njehsori nuk është në rregull dhe për këtë nuk është dhënë sqarim.

Sa i përket pikës së kundërshtimit se nuk duhet të merret parasysh krahasimi i shpenzimit të energjisë elektrike kjo nuk qëndron sepse shpenzimi i energjisë elektrike është indikacion mjaft i rëndësishëm në shqyrtimin e lëndëve të konsumatorëve, dhe se edhe KESCO është bazuar vetëm në procesin e kalibrimit. Bordi i ZRRE-së ka analizuar me kujdes shpenzimin e energjisë elektrike dhe konstaton se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve të energjisë elektrike. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së bërë rrjedhës së energjisë elektrike për periudhat kontestuese me njehsorin e vjetër elektrik-kontestues nr.35024160 dhe njehsorin e ri elektrik nr.67788719 për periudha të njëjta kohore, konstaton se konsumatori ka ndryshim të madhe të shpenzimeve të energjisë elektrike. Andaj me qëllim që të paraqetiten sa me qartë shpenzimet e konsumatorit, është bërë analizimi i shpenzimit të energjisë së konsumatorit për periudha të njëjta kohore me tre njehsorët elektrik që ka poseduar konsumatori. Shpenzimet mesatare mujore me njehsorin elektrik nr.34713817 për periudhën 01/2012 deri në periudhën 12/2012 është **312 kWh/muaj**, si dhe periudhën 01/2013 deri në periudhën 12/2013 mesatarja mujore e shpenzimit është **151 kWh/muaj**, me njehsorin kontestues elektrik nr.35024160 për periudhën 01/2016 deri në periudhën 12/2016 mesatarja mujore e shpenzimit është **847 kWh/muaj**, si dhe periudhën **01/2017** deri në periudhën 12/2017 mesatarja mujore e shpenzimit është **749 kWh/muaj**, si dhe me njehsorin e ri elektrik nr.67788719 mesatarja mujore e shpenzimit për periudhën 01/2018 deri në periudhën prill 2018 është **237 kWh/muaj**. Andaj Bordi i ZRRE thekson se bazuar në analizat e bëra vërtetohet se konsumatori për periudhën **01/2017 - 12/2018** me njehsorin kontestues elektrik nr.35024160 ka rritje prej **219%** krahasuar me shpenzimet në njehsorin nr.34713817 (periudha 01/2012 - 12/2014), kurse duke krahasuar shpenzimet e periudhës 01/2017-04/2017 me shpenzimet e të njëjtës periudhe 01/2018 - 04/2018 me njehsorin e ri elektrik nr. 67788719 vërtetohet se konsumatori me njehsorin kontestues ka rritje prej **222%**.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO se shpenzimi i faturura për periudhën 10.02.2014 e deri më 06.12.20147 është i saktë dhe bazuar në raportin e kalibrimit, kjo nuk qëndron ngase Bordi i ZRRE bazuar në të gjitha shkresat e lëndës konstaton se shpenzimet e faturuar me njehsorin elektrik



nr.35024160 për periudhën 10.02.2014 deri në periudhën 06.12.2017 nuk paraqesin shpenzime reale te konsumatorit, pasi që ndryshimi i kWh të faturuar për periudhën sa ka qenë i vendosur për matje njehsori nr.35024160 krahasuar me dy njehsorët e tjerë nr.34713817 dhe nr.67788719 është shumë i madh, andaj edhe konstaton se konsumatorit duhet t'i bëhen korrigjimet e të gjitha faturave me njehsorin elektrik nr.35024160 duke e faturuar konsumatorin me mesataren mujore të njehsorit nr. 67788719, prej TL=131 kWh dhe TU=106 kWh ashtu siç është cekur edhe në vendimin e organit të shkallës së parë të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.07.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit M. I. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.